



- SALSTAT -

BULETIN INFORMATIV

STATISTIKA TË FORTA VENDORE SHQIPTARE

Prill - Gusht 2022

Projekti "Strong Albanian Local Statistics" (Për Statistika të Forta Vendore Shqiptare, SALSTAT) është pjesë e projektit "Bashki të Forta", i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) për periudhën gusht 2018 - gusht 2022. Projekti "Bashki të Forta" fokusohet në aspekte të ndryshme të zhvillimit vendor në Shqipëri, në përkrahje të decentralizimit dhe qeverisjes vendore.

Nga Vlerësimi i Jashtëm i Projektit, u konfirmua se projekti SALSTAT për vitin 2021 arriti rezultate të matshme, në bazë të të cilave është marrë vendimi që projekti të ketë një periudhë të dytë zbatimi nga viti 2022 deri në vitin 2026.

Tri palët kyçe të interesit në këtë projekt janë INSTAT-i, bashkitë, si dhe disa ministri të linjës e agjenci qeveritare, veçanërisht ato që janë përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave statistikore dhe/ose janë përgjegjëse për të dhënat/regjistrat administrativë.

Në kuadër të fazës së re, SALSTAT do të intensifikojë bashkëpunimin me bashkitë dhe agjencitë e tjera qeveritare për të forcuar besimin te statistikat zyrtare dhe për të përfshirë palët e interesit në një diskutim lidhur me përfitimet nga statistikat zyrtare, qeverisjen demokratike dhe procesin e vendimmarrjes, veçanërisht sa i përket përmirësimit të detyrave, përgjegjësisë dhe funksioneve të bashkive.

Përmbajtja:

- Shpërndarja e Vjetarit Statistikor Rajonal 2021
- Hartimi i Vjetarit Statistikor Rajonal 2022
- Regjistri Statistikor i Ndërtesave dhe Banesave dhe Regjistri i Popullsisë dhe Familjeve
- Workshope me Zyrat Rajonale Statistikore
- Trajnime për stafin e Bashkive
- Trajnime për stafin e Shërbimit të Provës
- Trajnime për stafin e Zyrave të Gjendjes Civile për përmirësimin e Statistikave Vitale (Trajnim pilot)

Shpërndarja e Vjetarit Statistikor Rajonal 2021

Gjatë majit të vitit 2022, ekipi i projektit SALSTAT organizoi takime me disa kryetarë qarqesh në Fier dhe Elbasan. Qëllimi i këtyre takimeve ishte promovimi dhe diskutimi i veprimtarive që lidhen me qarqet dhe shkëmbimi i mendimeve lidhur me nevojat e qarqeve gjatë një faze të II-të të mundshme të SALSTAT.

Gjatë takimit, u diskutuan temat e mëposhtme:

- Paraqitja dhe dorëzimi i Vjetarit Statistikor Rajonal 2021 në gjuhën angleze dhe shqipe.
- Përmbajtja e "Vjetarit Statistikor Rajonal" dhe rëndësia e treguesve të kategorizuar në nivel rajonal dhe vendor;
- Projekti SALSTAT në kuadër të mbështetjes së INSTAT-it nga Qeveria Zvicerane dhe përmirësimit të të dhënave vendore;
- CENSI - Rëndësia dhe lidhjet e komisioneve në nivel bashkiak.

Hartimi i Vjetarit Statistikor Rajonal 2022

Gjatë prillit të vitit 2022, stafi i INSTAT nisi punën për Vjetarin Rajonal (VSR) për vitin 2022, me mbështetjen e vazhdueshme të ekspertit nga Zyra Federale e Statistikave të Zvicrës (ZFS).

Eksperti përmbushi një mision pranë INSTAT-it nga data 17 deri më 20 maj. Së bashku me hartuesin fillestar të Vjetarit Statistikor Rajonal (VSR) 2022, ata zhvilluan takime me drejtuesit e INSTAT dhe organizuan trajnime për hartuesit e VSR-së (stafi i INSTAT) sipas temave të mëposhtme:

- Hartuesit e VSR-së - udhëzimet dhe prioritetet e VSR-së 2022 - Hyrje
- Problematika me dorëzimin e kapitujve (problematikat dhe mësimet e marra)
- Punimi në Word dhe Excel, këshillat dhe mënyrat
- Pyetje dhe diskutime

Sipas planit të punës së INSTAT, publikimi i të dy varianteve të VSR-së (anglisht dhe shqip) parashikohet të bëhet më 15 dhjetor 2022.



Regjistri Statistikor i Ndërtesave dhe Banesave dhe Regjistri i Popullsisë dhe Familjeve


1. Në kuadër të Projektit SALSTAT, INSTAT po zbaton Regjistrin Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave (RSHSNB). Për këtë qëllim, u organizua një workshop në Neuchâtel nga data 21 deri 24 qershor 2022, në bashkëpunim me Zyrën Federale Zvicerane të Statistikave. Workshop-i u përqendrua në pikat e mëposhtme:

- Diskutime mbi situatën aktuale të zbatimit të Regjistrit Shqiptar Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave (RSHSNB); progresi i arritur dhe etapat për veprimtaritë e ardhshme;
- Përvoja e ZFS-së në Zvicër lidhur me Regjistrin Federal të Ndërtesave dhe Banesave;
- Prezantim dhe diskutim mbi përcaktimin dhe zbatimin e një nomenklature të re në Shqipëri (repertor).

Ndarja e përvojës me kolegët e zyrës së statistikave në Zvicër (ZFS) ishte e frytshme për të kuptuar se si funksionon regjistri, metodologjinë dhe ofruesit e mundshëm të të dhënave për përditësimin e regjistrit dhe nxjerrjen e statistikave bazuar në të dhënat e regjistrit.

Duhet të kihet parasysh që ndërtesat dhe banesat nuk janë diçka statike, por një sistem dinamik dhe në ndryshim të vazhdueshëm, ndaj lidhur me qarkullimin e të dhënave, duhet të ketë një ndarje të qartë midis regjistrit dhe hartuesve të të dhënave.

Nga diskutimet, dolën disa propozime për mënyrën e përditësimit të mundshëm të regjistrit statistikor në të ardhmen në Shqipëri, ku INSTAT do të ketë rol drejtues.



2. Gjatë periudhës nga data 6 deri 10 qershor 2022, eksperti i Regjistrit të Popullsisë dhe Banesave filloi misionin e tij të parë pranë INSTAT. Ai punoi ngushtësisht me Drejtorinë e Statistikave Sociale në INSTAT.

Më 7 qershor 2022, eksperti mbajti një seminar me drejtuesit e INSTAT me temë: "Tranzicioni drejt një censi të bazuar në regjistra".



Misioni i tij i dytë u zhvillua nga data 16 deri 19 gusht 2022. Më 17 gusht, eksperti mbajti një seminar me stafin e INSTAT me temë: "Regjistri i Popullsisë: rasti i Holandës".

Seminari u përqendrua në shembullin e Holandës lidhur me Censin e bazuar në regjistra.



Workshop me stafin e Zyrave Rajonale Statistikore

Në data 14 dhe 15 prill 2022, u mbajt në Tirana International Hotel një workshop me stafin e Zyrave Rajonale Statistikore (ZRS) me mbështetjen e ekipit të Censit.

Në workshop-in 2 ditor, morën pjesë 49 punonjës nga të 28 Zyrat Rajonale Statistikore, 10 prej të cilëve mbanin postin e drejtuesit dhe 39 të tjerët atë të specialistit. Të pranishëm nga zyrat qendrore të INSTAT ishin Drejtori i Përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm dhe drejtues të tjerë të drejtorive kryesore të institucionit.

Diskutimet më të rëndësishme u përqendruan te plani vjetor i punës, Censi i radhës, dhe pritshmëritë e ZRS-ve lidhur me mbështetjen nga stafet bashkiake për mbledhjen e të dhënave të ndryshme.



Trajnime për stafin e Bashkive

1. Më 31 maj 2022, u përmbyll seria e trajnimeve me stafin e bashkive për "**Microsoft Excel i Avancuar**". Trajnimi nisi më 19 prill dhe u organizua në grupe të vogla me trajnime dy ditore për çdo grup. Leksionet u mbajtën nga një ekspert vendas për "Microsoft Excel".

Gjithsej, u trajnuan 110 punonjës të bashkive nga të cilët 77 vetë ose 70% ishin gra.

Gjithsej, u trajnuan përfaqësues të stafit nga 50 bashki, nga 61 gjithsej në vend, ose me fjalë të tjera nga 82% e bashkive.



2. Nga data 5 deri 12 maj 2022, SALSTAT / INSTAT në bashkëpunim me projektin Helvetas përfunduan trajnimin për **“Platformën online të mbledhjes së të dhënave për Statistikat e Menaxhimit të Mbetjeve Shtëpiake”** me stafin e bashkive dhe drejtuesit përkatës të Zyrave Rajonale Statistikore (ZRS).

Temat kryesore që u diskutuan gjatë trajnimit ishin:

- Statistikat për mbetjet urbane në bashki
- Problematikat e hasura nga bashkitë në plotësimin e anketës gjatë vitit të fundit, veçanërisht lidhur me konceptet dhe përkufizimet (INSTAT)
- Metodologjia për prodhimin dhe mbledhjen e të dhënave (Helvetas)
- Aplikimi i mbledhjes së të dhënave (INSTAT)
- Baza ligjore dhe parimi i konfidencialitetit statistikor

U trajnuan gjithsej 54 punonjës, prej të cilëve 26 ishin gra, ose 48% e numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve. Gjithashtu, trajnimi u ndoq edhe nga 22 punonjës nga 18 Zyrat Rajonale Statistikore.

Gjithsej, trajnimi u ndoq nga 76 pjesëmarrës dhe u trajnuan përfaqësues të stafit nga 43 bashki, nga 61 gjithsej në vend, ose me fjalë të tjera nga 70% e bashkive.

Link-u i faqes së anketës i është dërguar të gjitha bashkive dhe departamenti i statistikave për mbetjet po mbështet punonjësit me plotësimin online të anketës për Menaxhimin e Mbetjeve Familjare. Ata plotësuan me sukses anketën online deri në fund të korrikut dhe të dhënat do të publikohen në shtator të vitit 2022.



3. Nga data 7 deri 23 qershor 2022, u organizua trajnimi për **"Mbledhjen, redaktimin dhe përpunimin dhe analizën e të dhënave"** me stafin e bashkive. Trajnimi nisi më 7 qershor dhe u organizua në seanca dy ditore për çdo grup. Leksionet u mbajtën nga stafi i INSTAT dhe dy ekspertë kombëtarë vendas.

Agjenda e trajnimit ishte si më poshtë:

- Infrastruktura e përgjithshme statistikore
- Mbledhja, redaktimi i të dhënave shoqërore
- Mbledhja, redaktimi i të dhënave ekonomike dhe të sipërmarrjes
- Tregu i punës dhe treguesit e çmimeve
- Plotësimi i pyetësorit nga bashkitë
- Analiza statistikore e të dhënave

Gjithsej, u trajnuan 93 pjesëtarë të stafit të bashkive.

Gjithsej, u trajnuan përfaqësues të stafit nga 49 bashki, nga 61 gjithsej në vend, ose me fjalë të tjera nga 80% e bashkive.



Trajnime për stafin e Shërbimit të Provës

Nga data 18 deri 21 korrik, u organizua një trajnim me stafin e Shërbimit të Provës lidhur me Excel-in dhe analizimin e përpunimit të të dhënave. Dy grupe u trajnuan nga dy ditë secili. Leksionet u mbajtën nga dy ekspertë kombëtarë vendas.

Agjenda e trajnimit ishte si më poshtë:

1. Microsoft Excel
2. Analiza dhe përpunimi i të dhënave

Gjithsej, u trajnuan 25 punonjës.



Trajnime për stafin e Zyrave të Gjendjes Civile për përmirësimin e Statistikave Vitale (Trajnim pilot)

Në korrik të vitit 2022, Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi.

Marrëveshja u nënshkrua nga dy përfaqësuesit e institucioneve, përkatësisht Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT Znj. Elsa Dhuli dhe Drejtori i Përgjithshëm i DPGJC Z. Vangjush Stavro.

Në kuadër të këtij memorandumi, do të organizohen një sërë trajnimesh me qëllim ngritjen e kapaciteteve që lidhen me përmirësimin e cilësisë së statistikave vitale në nivel vendor. Trajnimet do të mbështeten me logjistikë nga projekti SALSTAT.



Për këtë qëllim, në datat 1 dhe 2 gusht 2022 u organizua një trajnim dy ditor pilot me stafin e Zyrave të Gjendjes Civile në qarkun e Korçës (Bashkitë Korçë, Pogradec, Kolonjë, Devoll dhe Maliq, së bashku me të gjitha njësitë administrative). Në trajnim, morën pjesë gjithsej 41 punonjës.

Agjenda e trajnimit u përqendrua në përmirësimin e statistikave vitale dhe temat kryesore të trajtuara ishin: rëndësia e trajnimit, kuadri ligjor për Sistemin Kombëtar të statistikave zyrtare për regjistrimin civil dhe ngjarjet vitale, mbledhja dhe regjistrimi i të dhënave vitale nga DPGJC-ja. Gjatë trajnimit, u analizuan statistikat vitale dhe proceset e ndjekura nga INSTAT lidhur me heqjen e dublikatave, të dhënat që mungojnë, inferencat, vlerat ekstreme dhe nevojën për shtimin e variablave.

DPGJC-ja shpjegoi procedurat e regjistrimit të shtetasve të huaj, të adresës së qytetarëve dhe zbatimin e dekreteve të nxjerra nga institucioni i Presidentit për marrjen/heqje dorë nga shtetësia.



FALEMINDERIT NGA EKIPI SALSTAT!

Menaxher projekti:

Martin Teichgräber, Zyra Federale Zvicerane e Statistikave

Koordinatorë:

Eralda Pushaj, Koordinatore me Njësitë e Qeverisjes Qendrore

Edlira Çeliku, Koordinatore Administrative dhe Financiare

Alketa Doçi, Koordinatore për Regjistrat dhe të Dhënat Administrative

Instituti i Statistikave - Tiranë

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017

Email: info@instat.gov.al

Telefon: +355 (4) 2233356 / 2233358